

L I G J
Nr.8198, datë11.3.1997

**PËR AMNISTINË PËR PERSONAT CIVILË DHE USHTARAKË QË U IMPLIKUAN NË
REVOLTAT PAS FALIMENTIMIT TË SKEMAVE PIRAMIDALE MASHTRUESE**

Në mbështetje të nenit 16, pikat 2 dhe 6 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", nisur nga marrëveshja e partive politike shqiptare e datës 9 mars 1997, me propozimin e një grupi deputetësh

**KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

Neni 1

Përfshihen nga ndjekja penale dhe nga vuajtja e mëtejshme e dënimit personat civilë dhe ushtarakë që, pas falimentimit të skemave piramidale mashtruese, gjatë periudhës sërevoltave nga data 10 janar, deri 11 mars 1997, ora 20⁰⁰, kanë kryer vepra penale, me përjashtim të atyre që kanë kryer krimin e vrasjes me dashje ose paramendim, si dhe të atyre që kanë kryer krime që nuk lidhen me këto revolta.

Neni 2

Personat që disponojnë armë, municione e materiale të tjera ushtarake dhe që nuk do të kryejnë vepra penale pas datës 11.3.1997, përfshihen nga ndjekja penale në qoftë se deri më datën 20.3.1997 dorëzojnë armët, municionet e materialet e tjera ushtarake.

Neni 3

Për zbatimin e këtij ligji, ngarkohen Ministria e Drejtësisë, Ministria e Brendshme, Ministria e Mbrojtjes dhe Prokuroria e Përgjithshme.

Neni 4

Ky ligj hyn nëfuqi mëdatë11.3.1997, ora 20⁰⁰.

Shpallur me dekreten nr.1736, datë 12.3 1997 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha